



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:261415

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05484755

P.nr.30/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PEJE-DEGA KLINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, sipas Gjyqtares se vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Liridona Palushi, në lëndën penale kundër të pandehurit A (R) L , nga fsh. Sh. V -R K-Pejë ku tani banon në rr "M B "- F e P K-Pejë , i akuzuar për vepër penale ,Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par 8 lidhur me par 1 dhe 6 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Peje - Departamenti i Përgjithshëm, me PP/II Nr.1763/2022 të datës 10.02.2023, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur në praninë e Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala, dhe të pandehurit me dt. 26.02.2024, ndërsa me dt. 21.03.2024, e përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj:

Të pandehurit A (R) L i lindur me dt. 23.09.1969 në fshatin . Sh V -R K-P ,tani me banim në rr" M B " -F.P , K-P , i biri i R dhe nënës X , i gjinisë H , ka të kryer shkollën mesme ekonomike , , me profesion taksist , i gjendjes së mesme ekonomike ,i identifikuar ne bazë të letërnjoftimit me nr....., i nacionalitetit Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datën ... rreth orës në fsh . G.K-K në aksin rrugor P-P , nga pakujdesia ka shkelur nenin 53 të Ligjit për Rregullat e Trafikut rrugor në atë mënyrë që përderisa i pandehuri ishte duke vozitur automjetit e tij të markës "VW" me ngjyrë të bardhë, me targa të

regjistrimit 03-430-HH, me ç' rast nga mos përshtatja e shpejtësinë së lëvizjes me kushtet e rrugës , për shkak se ishte duke ra riga shiu , i pandehuri pasi që ishte teposhtëzë kishte frenuar ku asfalti ishte i lagur , dhe në këtë rast i pandehuri e humb kontrollin mbi automjet, dhe kalon në shiritin e kundërt , ku me pjesën ballore e godet në skajin e përparme të anës së majtë dhe e përplas me anën e djathtë në breg të dheut , automjet Volvo, ngjyrë e hirit me targa, të cilin e drejtonte i dëmtuari P. A, ndërsa i pandehuri me veturën e tij pas goditjes, kalon jashtë rrugës në të djathtë ku sillet dhe përfundon prapë në rrugë, e si pasojë e aksidentit sipas ekspertizës ligjore të punuar për rastin lëndime trupore kanë pësuar: drejtuesi i automjetit (A) , A . L , pasagjeri i tij Z.M, drejtuesi i automjetit (B) ,P.A dhe pasagjerët e tij Gj. A , L. A, V. A, dhe lëndime të rënda trupore ka pësuar L A.

-me çka ka kryer veprën penale "Rrezikim i trafikut publik" nga neni 370 par 8 lidhur me par 1 dhe 6 të KPRK-së.

GJYKON
DËNIM ME KUSHT

Andaj:

I.Të pandehurit A.L e dënon më dënim burgimi në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim, nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) viti, në qoftë se i pandehuri, gjatë kësaj kohe verifikuese nuk kryen vepër tjetër penale.

II.Dënimi me kusht i revokohet konform nenit 50 nëse i pandehuri brenda një viti kryen vepër të re penale.

III.Obligohet: i akuzuari në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 (njëzet) euro, në emër të shpenzimeve për ekspertizë të komunikacionit (40) € ,në emër të ekspertizës mjeko ligjore tridhjetë (30) €, si dhe në emër të tarifës për kompensimin e viktimave shumën në vlerë prej 30 (tridhjetë) euro, gjithsejte njëqind e njëzet (120) Euro.

IV.Dënim plotësues: I shqiptohet të akuzuarit konform nenit 65 par.1 dhe 2 të KPRK-së, marrja e lejes së vozitjes në kohëzgjatje prej një (1) viti, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V. Udhëzohet: Pala e dëmtuar L. A nga Fsh. Sh. K. Klinë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Peje – Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngrit aktakuzën PP/II nr.1763/2022 të datës 10.02.2024 kundër të pandehurit A (R) L nga fshati Sh i V -R. K-P, tani me banim në Rr” MB “ -F.P K-P, i akuzuar për veprë penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par 8 lidhur me par 1 dhe 6 të KPRK-së ,duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Peje – Departamenti i Përgjithshëm, me, ashtu qe pas administrimit të provave i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me date 10.02.2024 ne praninë e Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala, të pandehurit A. L, mbrojtësit të caktuar ex officio, av. Rrustem Lajqi.

Pas leximit te aktakuzës nga prokurori i shtetit Ramiz Buzhala, i pandehuri A. L , pasi e kuptoi, aktakuzën, është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale qe i vihet në barrë. Të njëjtit i vjen keq për veprën e kryer jam i penduar thellë për veprën e kryer në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale por kjo është bërë nga pakujdesia ime . I pandehuri deklaroi se nga momenti kur ka ndodh aksidenti e deri në ditën e sotme jam kujdesur për shëndetin e të dëmtuarës, kam shkuar në spital qe ti vizitoj me të dëmtuarit jemi pajtuar dhe nga ajo ditë kemi vazhduar ti kemi marrëdhëniet e mira.

Prokurori i shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurit, i njëjti është bërë në mënyrë të plot konform dispozitave ligjore, pasi i pandehuri e pranon fajësinë,

e ky pranim fajësisë gjen mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. I propozoi gjykatës që ta aprovoi pranimin e fajësisë, dhe kërkoj nga gjykata që të pandehurin ta shpalli fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

Mbrojtësi i të pandehurit Av. Rrustem Lajçi deklaroi se e përkrahi të pandehurin për pranimin e fajësisë të cilin e ka bërë me vullnet dhe pa presion dhe kërkoj nga gjykata ta aprovoj pranimin e fajësisë dhe të marrë si rrethanë të posaçme lehtësuese në rast të ndonjë shqiptimi të dënimit në rast të marrjes së vendimit, ia përkujtoj gjykatës se si rrethanë lehtësuese është gjendja e varfër ekonomike jeton prej 6 anëtarëve bashkëshorten e ka të sëmur andaj konsideroj se një dënim sa më i ult do të arrinte qëllimin e dënimit.

Pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë, mendimit të prokurorit se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare, pa asnjë presion. I pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par. 1 të KPPRK-se, janë përmbushur.

Ashtu që gjykata me aktvendim në procesverbal aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili pranim fajësisë, është konform neni 242 të KPPRK-së, dhe i cili është i vetëdijshëm për pasojat dhe privilegjet e pranimin të fajësisë.

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 258 par.1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.2 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par.1 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit dhe nuk e ekziston asnjë rrethanë konform neni 248 par 4 të KPPRK-se, për hudhje të aktakuzës.

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 1 dhe 6 të KPPRK-së. Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo

përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës, për veprën penale me të cilën është akuzuar.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së.

Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata gjeti se i pandehuri ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar e për më tepër ka pranuar fajësinë dhe ka shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer, nga pakujdesia gjendjen e dobët ekonomike, si dhe që i njëjti është mbajtës i vetëm i familjes. I pandehuri deklaroi se nga momenti kur ka ndodhur aksidenti e deri në ditën e sotme jam kujdesur për shëndetin e të dëmtuarës, kam shkuar në Spital që ti vizitoj, dhe nga ajo ditë kemi marrëdhënie të mira. Si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata muar se i njëjti është mbajtës i vetëm i familjes, 8 anëtarësh, me të ardhura minimale.

Ndërsa sa i përket rrethanave rënduese Gjkata nuk gjeti asnjë rrethanë, përpos që vepra penale është kryer nga pakujdesia, nga ana e të pandehurit.

Gjkata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjkata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pajtim me nenin 38 të KPRK-së, si dhe në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikojë edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Duke u bazuar në nenin 453 par. 1 të KPRK-së, gjykata ka obliguar në pagimin e shpenzimeve e procedurales dhe shpenzimet për ekspertizë të komunikacionit, dhe për ekspertizë mjeko ligjore.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par. 3 nënpar. 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Konform dispozitave ligjore të nenit 463 të KPRK-së, u vendos për kërkesën pasurore juridike duke udhëzuar palën e dëmtuar që kompensimin e dëmit ta realizojë në kontest të rregulltë civil.

Andaj nga arsyet e theksuara me lartë, dhe konform dispozitave ligjore të nenit 25 par.2, 26 par.2, 297, 365 dhe 470 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

Departamenti i Përgjithshëm Penal

P.nr.30/2023 me datë. 21.03.2024

Zyrtare ligjore
Liridona Palushi

Gjyqtarja Gjykuese
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejte të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.